



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2023:162515  
Datë: 04.11.2024  
Numri i dokumentit: 06395928

**K.DH.Shk II.nr. 1357/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami në çështjen përmbarimore të kreditorit “Agromarket KS” D.O.O., me NUI:811183293, me seli në Graçanicë, fshati Llapnasellë, kundër debitorit “Agrosistemi”, me NUI:810723991, me seli në Lipjan, rruga “Avdi Kelmendi” p.n., përfaqësuar sipas autorizimit nga Valdet Zeqiri, avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1156/23 të datës 27.12.2023, me datë **24.10.2024**, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pathemeltë ankesa e debitorit “Agrosistemi”, me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1156/23 të datës 27.12.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1156/23 të datës 27.12.2023, në pikën e parë të dispozitivit ka aprovuar pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit “Agrosistemi”, ashtu që është anuluar pjesërisht Urdhri për lejimin e përmbarimit P.nr.295/23 të datës 03.07.2023, të Përmbaruesit Privat Kushtrim M. Musa, për pjesën sa i përket detyrimit në shumën prej 12,988.86 €. Ndërsa, në pikën II të dispozitivit ka lënë në fuqi pjesën tjetër të Urdhrit për lejimin e përmbarimit P.nr.295/23 të datës 03.07.2023, të Përmbaruesit Privat Kushtrim M. Musa, për pjesën e detyrimit kryesor në shumën prej 464.80 €, së bashku me kamatën ligjore sipas normës vjetore të interesit në lartësi prej 8% .

Në pikën III të dispozitivit është përfunduar pjesërisht procedura përbarimore e kreditorit “Agromarket KS” D.O.O., me seli në Prishtinë, ndaj debitorit “Agrosistemi”, sipas urdhrorit përbarimor P.nr.295/23 të datës 03.07.2023, të Përmbauesit Kushtrim M. Musa, për shumën prej 12,988.86 €.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1156/23 të datës 27.12.2023.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

### **Ankesa e debitorit është e pathemeltë.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Përmbauesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Agromarket KS” D.O.O., ka lëshuar urdhër me të cilin e ka lejuar përbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës Nr. 14-0605/23-021 të datës 05.06.2023, Faturës Nr. 14-0602/23-006 të datës 02.06.2023, Faturës Nr. ROSAJ0524/23-003 të datës 24.05.2023, Faturës Nr. 14-0509/23-005 të datës 09.05.2023, Faturës Nr. ROSAJ0502/23-009 të datës 02.05.2023, Faturës Nr. ROSAJ0424/23-012 të datës 24.04.2023, Faturës Nr. 14-0424/23-057 të datës 24.04.2023, Faturës Nr. ROSAJ0405/23-003 të datës 05.04.2023, Faturës Nr. 14-0405/23-005 të datës 05.04.2023, Faturës Nr. ROSAJ0329/23-002 të datës 29.03.2023, Faturës Nr. ROSAJ0329/23-001 të datës 29.03.2023, dhe Faturës Nr. 14-0329/23-001 të datës 29.03.2023, me të cilin ka detyruar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimi të këtij urdhri t’ia paguaj kreditorit shumën prej 13,453.66 € me kamatëvonesë prej 8% nga dita e lëshimit të faturës e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore, ashtu që përmbauesi borxhin ta inkasoi me ndalimin e mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogaritë bankare dhe bartjen e shumës përkatëse në llogarinë e kreditorit, si dhe me regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit deri në realizimin e borxhit në tërësi

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka theksuar ndër të tjerash se debitori në tërësi e konteston urdhrin përbarimor për faktin se i njëjti i ka përmbushur detyrimet e tij. Tutje ka shtuar se debitori ka përmbushur të gjitha detyrimet ndaj kreditorit përveç shumës prej 464.80 €, e cila debitorit i takon si rabat sipas marrëveshjes që ka pasur me kreditorin, po ashtu pagesat debitori i ka bërë para pranimi të urdhrorit përbarimor me datë 05.07.2023. Gjykatës i ka propozuar që të aprovohet si i bazuar prapësimi i debitorit, ndërsa urdhri për përbarim të anulohet, si dhe të detyrohet kreditori që debitorit t’ia kompensoj shpenzimet e përpilimit të prapësimi sipas TOAK 312.00 €. Kreditori

në përgjigjen në prapësim, përmes email-it, ka theksuar se debitori ka përmbushur një pjesë të obligimit, ndërsa pjesa e obligimit të mbetur është 464.80 €.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1156/23 të datës 27.12.2023, ku në pikën e parë të dispozitivit ka aprovuar pjesërisht si i bazuar prapësimin e debitorit “Agrosistemi”, ashtu që është anuluar pjesërisht Urdhri për lejimin e përmbarimit P.nr.295/23 të datës 03.07.2023, të Përmbaruesit Privat Kushtrim M. Musa, për pjesën sa i përket detyrimit në shumën prej 12,988.86 € Ndërsa, në pikën II të dispozitivit ka lënë në fuqi pjesën tjetër të Urdhrit për lejimin e përmbarimit P.nr.295/23 të datës 03.07.2023, të Përmbaruesit Privat Kushtrim M. Musa, për pjesën e detyrimit kryesor në shumën prej 464.80 €, së bashku me kamatën ligjore sipas normës vjetore të interesit në lartësi prej 8% .

Në pikën III të dispozitivit është përfunduar pjesërisht procedura përmbarimore e kreditorit “Agromarket KS” D.O.O., me seli në Prishtinë, ndaj debitorit “Agrosistemi”, sipas urdhrit përmbarimor P.nr.295/23 të datës 03.07.2023, të Përmbaruesit Kushtrim M. Musa, për shumën prej 12,988.86 €.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata ka vlerësuar se Urdhri përmbarimor P.nr.295/23 i datës 03.07.2023 duhet të anulohet pjesërisht për borxhin e kërkuar nga kreditori sipas Faturës Nr. 14-0605/23-021 të datës 05.06.2023, Faturës Nr. 14-0602/23-006 të datës 02.06.2023, Faturës Nr. ROSAJ0524/23-003 të datës 24.05.2023, Faturës Nr. 14-0509/23- 005 të datës 09.05.2023, Faturës Nr. ROSAJ0502/23-009 të datës 02.05.2023, Faturës Nr. ROSAJ0424/23-012 të datës 24.04.2023, Faturës Nr. 14-0424/23-057 të datës 24.04.2023, Faturës Nr. ROSAJ0405/23-003 të datës 05.04.2023, Faturës Nr. 14-0405/23-005 të datës 05.04.2023, Faturës Nr. ROSAJ0329/23-002 të datës 29.03.2023, Faturës Nr. ROSAJ0329/23-001 të datës 29.03.2023, dhe Faturës Nr. 14-0329/23-001 të datës 29.03.2023. Gjykata erdhi në këtë përfundim, pasi që në bazë të provave që gjenden në shkresa të lëndës, përkatësisht në bazë të deklarimeve të debitorit të cekura në prapësim, si dhe dëshmive të pagesave me numër 77705845355005 e datës 22.06.2023, 77705875375005 e datës 05.07.2023, 77705875299005 e datës 05.07.2023, 77705875929006 e datës 05.07.2023, 77705875325006 e datës 05.07.2023, 77705779055005 e datës 31.05.2023, 77705817181005 e datës 12.06.2023, 77705683188000 e datës 23.06.2023, debitori ka arritur të përmbush pjesërisht detyrimin në shumën prej 12,988.86 €..

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit, duke lënë në fuqi pjesën tjetër të urdhrit P.nr.295/23 të datës 03.07.2023 për shumën në vlerë prej 464.80 €, për faktin se faturat në bazë të cilave është lejuar urdhri për përmbarim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur në pikën I të dispozitivit ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit duke shfuqizuar urdhrin përmbartimor për pjesën e borxhit prej 12,988.86 €, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikim nga shkresat e lëndës konstatohet se borxhi i kërkuar nga kreditori me propozimin për përmbartim dhe i lejuar me urdhrin e Përmbartuesit Privat Eset Murati është përmbushur pjesërisht nga ana e debitorit në vlerë prej 12,988.86€, fakt ky që vërtetohet nga dëshmitë e pagesave me numër 77705845355005 e datës 22.06.2023, 77705875375005 e datës 05.07.2023, 77705875299005 e datës 05.07.2023, 77705875929006 e datës 05.07.2023, 77705875325006 e datës 05.07.2023, 77705779055005 e datës 31.05.2023, 77705817181005 e datës 12.06.2023, 77705683188000 e datës 23.06.2023, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, e të cilat pagesa janë pohuar edhe nga ana e kreditorit. Andaj, faturat në bazë të cilave është lejuar urdhri përmbartimor e kanë humbur pjesërisht efektin sepse të njëjtat janë përmbushur pjesërisht nga ana e debitorit ne kuptim të nenit 71 par1 nëpar.1.2 të LPP-së me të cilin parashihet se “ *dokumenti në bazë të cilit është marr vendimi përmbartues ose urdhri përmbartues është prishur anuluar, ndryshuar ose shfuqizuar në një mënyrë tjetër, gjegjësisht nëse në ndonjë mënyrë e ka humbur efektin e tij ose është konkluduar se është pa efekt juridik*”.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles se dytë, sa i përket pikës II të dispozitivit vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit ndërsa ka lejuar urdhrin përmbartimor në shumën prej 464.80 € ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate konstatohet se përmbartimi është lejuar në bazë të faturave të lëshuara nga kreditori, të cilat përmbajnë elementet që kërkohen me nenin 29 paragrafi par.3 i cili përcakton se “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshme për përmbartim po qe se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes se detyrimit monetar*”.

Gjykata e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim ne pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës e dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Gjykata vlerësoi pretendimet e kreditorit se shuma prej 464.80 €, debitorit i takon si rabat sipas marrëveshjes që ka pasur me kreditorin por te njëjtat mbesin te pabazuara pasi nuk ka arrit ti argumentoj me prova juridikisht te vlefshme ashtu siç kërkon neni 69.4 i LPP dhe si te tilla i refuzoj ndërsa aktvendimin e ankimuar e vërtetoj.

Përndryshe në procedurën përmbartimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbartimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet

ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkalles së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,  
Dhoma e Shkalles së Dytë  
K.DH.SH.II nr.1357/24 me datë 24.10.2024**

**Gjyqtari,  
Faton Bajrami**